COMMUNICATING EUROPE

Membership Negotiations

ISSUE BRIEF | Shtator | 2020

Opinionet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të fondacionit Friedrich Ebert ose organizatave për të cilat punojnë autoret.

ZONA EKONOMIKE RAJONALE

Tre vjet pas krijimit – Zbatimi deri më tani dhe e ardhmja

Vështrim i përgjithshëm mbi situatën aktuale

Florensa Haxhi, PhD
EU Policy Hub

Përmbledhje ekzekutive

Integrimi ekonomik i Ballkanit Perëndimor nëpërmjet krijimit të një Zone Ekonomike Rajonale, që do të çojë më pas drejt krijimit të një tregu të përbashkët, është kthyer tashmë në një synim jo vetëm për vendet e rajonit, por dhe për BE-në. Themelet për një integrim ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor, janë hedhur që me hartimin e Strategjisë së Evropës Juglindore 2020, e cila është hartuar në vitin 2011 dhe shërben si një kornizë konvergjence për anëtarësimin në BE me objektiva të përbashkëta rajonale. Këto themele janë përforcuar nëpërmjet marrëveshjes së udhëheqësve të rajonit për zhvillimin dhe zbatimin e masave të Planit Disavjeçar të Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale (REA MAP) në vitin 2017, në Samitin e Triestes, të ndarë në 4 shtylla, si: tregtia, investimet, lëvizshmëria dhe fusha digjitale. Gjatë 3 viteve të kaluara, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë një numër iniciativash të përbashkëta për ta arritur këtë qëllim. Shumica e këtyre iniciativave ka çuar në arritjen e disa rezultateve me impakt të kënaqshëm për vendet e rajonit, si: eliminimi i tarifave dhe kuotave për tregtinë e produkteve industriale dhe bujqësore, përparimet e bëra në lehtësimin e tregtisë dhe negociatat për tregtinë e shërbimeve në kontekstin e CEFTA, reduktimi deri në eliminimin e plotë të tarifave roaming në rajon që ndikon drejtpërdrejtë tek publiku, duke ulur ndjeshëm kostot e komunikimit për qytetarët dhe bizneset, etj. Ndërsa iniciativa të tjera si heqja e pengesave për lëvizjen e fuqisë punëtore profesioniste, apo njohja e ndërsjellë e kualifikimeve akademike, janë ende duke u zhvilluar.

Axhenda e Ndërlidhjes (Connectivity Agenda) është një instrument që ka ndihmuar ndër vite në implementimin e projekteve të përbashkëta të investimeve në fushën e transportit dhe energjisë, si brenda rajonit, ashtu edhe me BE-në. Kjo agjendë shërben si një mekanizëm për materializimin në projekte konkrete të disa prej masave dhe objektivave të përfshira në Planin Disavjeçar të Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale (REA MAP). Megjithëse një numër i konsiderueshëm projektesh janë hartuar e zbatuar në kuadër të këtij instrumenti, ka ende shumë për t'u bërë. Përpjekjet e ndërmarra deri më tani nga vendet, për të financuar projekte me impakt rajonal, duhet të intensifikohen për të arritur krijimin e një zone ekonomike të mirëfilltë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Më shumë informacion lidhur me Agjendën e Ndërlidhjes mund të gjendet në linkun

Deklarata e Zagrebit, në maj të vitit 2020, theksoi dhe njëherë mbështetjen e BE-së për thellimin e integrimit ekonomik rajonal, duke u mbështetur në rregullat dhe standardet e BE-së dhe duke sjellë

rajonin dhe kompanitë e tij, më pranë Tregut të Brendshëm të BE-së. Kjo synohet të arrihet, ndër të tjera, dhe përmes zhvillimit më tej të Zonës Ekonomike Rajonale (REA), nëpërmjet masave konkrete të përfshira në Planin e ri Disavjeçar të Veprimit 2021-2024 dhe të dakordësuara nga udhëheqësit e 6 vendeve. Objektiv kyç në këtë plan veprimi, është rimëkëmbja ekonomike e 6 vendeve pas krizës së Covid-19, duke e bërë rajonin më tërheqës për investime të huaja. Më shumë informacion lidhur me këtë Deklaratë mund të gjendet në linkun

Përfitimet e krijimit të një Zone Ekonomike Rajonale

Ekzistojnë një numër përfitimesh që vijnë nga krijimi i një zone të tillë ekonomike.

- Përshpejton bashkëpunimin ekonomik rajonal i cili gradualisht do të lejojë intensifikimin e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, investimeve dhe punëtorëve të kualifikuar, në koherencë me zhvillimin e secilit vend. Po ashtu, nxit zhvillimin e politikave që bëjnë të mundur lidhjen midis ekonomive rajonale dhe BE-së dhe zvogëlojnë hendekun që ekziston midis rajonit dhe BE-së.
- Përmirëson stabilitetin e mëtejshëm makroekonomik dhe reformat strukturore, në kontekstin e Programeve të Reformës Ekonomike dhe krijon kushtet për një rritje më të madhe ekonomike. Integrimi ekonomik rajonal mund të ndihmojë sektorin privat të korrë ekonomitë e shkallës së një tregu prej 20 milion konsumatorësh dhe të përqendrojë modelin e rritjes drejt faktorëve, si: përmirësimi i aftësive të kapitalit njerëzor, investimet në infrastrukturën e inovacionit dhe digjitalizimi i ekonomive dhe shoqërisë, për t'i bërë ato më elastike ndaj sfidave të shekullit 21.
- Krijimi i Zonës Ekonomike Rajonale shërben si një gur i rëndësishëm për Ballkanin Perëndimor, për t'u integruar më mirë në zinxhirët e vlerave evropiane dhe globale dhe për t'u bashkuar më shpejt me pjesën tjetër të kontinentit. Ajo përmirëson aksesin e mallrave rajonalë në tregjet evropiane, përmes përmirësimit të kapacitetit të prodhuesve rajonalë, për të adoptuar standardet sanitare të Bashkimit Evropian dhe për të tejkaluar pengesat teknike për tregtinë. Po ashtu, krijimi i një zone të tillë, ndihmon në krijimin e një rrjeti të aktorëve të sektorit privat nga vendet e BE-së dhe ato të rajonit me qëllim lidhjen e operatorëve kryesorë ekonomikë dhe industrive të BE-së me sektorët më pak të zhvilluar të rajonit, për t'i përfshirë ata në zinxhirët e vlerës evropiane ose globale.
- Krijimi i një zone të tillë luan rol në kanalizimin e fondeve të BE-së drejt zhvillimit ekonomik dhe objektivave të infrastrukturës dhe gjithashtu ndihmon rajonin në sigurimin e financimit të projekteve nga donatorë të tjerë. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet hartimit dhe "lobimit" për financim të projekteve të përbashkëta rajonale me impakt në 2 ose më shume vende të rajonit, ose nëpërmjet nxitjes së iniciativave rajonale në hartimin e politikave të përbashkëta që mund të çohen përpara nëpërmjet sigurimit të financimit nga BE-ja dhe/apo donatorë të tjerë.
- Zhvillimi i një Zone Ekonomike Rajonale shërben për të theksuar dhe njëherë angazhimin e Ballkanit Perëndimor për integrim ekonomik dhe për të adoptuar parimet e BE-së. Nëpërmjet kësaj iniciative vendet e BP-së, bien dakord për të miratuar së bashku një strategji reforme që imponon në marrëdhëniet ekonomike rajonale të njëjtat parime dhe disiplina që do të duhej të respektonin nëse do të ishin anëtare të BE-së. Zhvillimi i një Zone të tillë Ekonomike ndikon në jetën e përditshme të popullsisë së rajonit, si dhe ndikon në forcimin e marrëdhënieve midis vendeve të Ballkanit Perëndimor për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre bilaterale. Kjo ndihmon dhe në pranimin e integrimit të rajonit në BE nga shtetet anëtare që janë ende skeptikë, pasi është më e lehtë të pranojnë një rajon i cili është i integruar mirë ekonomikisht.

Pandemia dhe ndikimi i saj

Pandemia COVID-19, e cila preku pa përjashtim të gjitha ekonomitë e vendeve të globit, pritet të ketë pasoja socio-ekonomike të rënda për Ballkanin Perëndimor. Në këtë kuadër, integrimi ekonomik rajonal, duhet të konsiderohet si një pjesë e pandashme e përpjekjeve socio-ekonomike të rimëkëmbjes së Ballkanit Perëndimor. Synimi duhet të jetë zhvillimi i një tregu të përbashkët rajonal, bazuar në standardet e BE-së dhe në zbatimin e

politikave që favorizojnë tranzicionine gjelbër dhe transformimin digjital. Politika të tilla pritet të kenë impakt pozitiv në kapërcimin e pasojave të pandemisë. Veprimet e përbashkëta në këtë drejtim, sigurojnë angazhimin e Ballkanit Perëndimor dhe riafirmojnë dhe njëherë perspektivën e tij brenda BE-së.

Shpërthimi i COVID-19 dhe masat shoqëruese në Ballkanin Perëndimor, parashikohen të ndikojë në reduktimin e rritjes ekonomike të vendeve të rajonit. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, kjo pritet të reflektohet dhe në Prodhimin e Brendshëm Bruto të këtyre vendeve, që parashikohet të ulet nga 9.0%, në 3.0 % në vitin 2020. Rimëkëmbja pritet të jetë relativisht e ngadaltë në 2021, ndërsa efektet e pandemisë zbehen. Dobësitë specifike të ekonomive të BP-së, janë të lidhura ngushtë me goditjet e jashtme, duke përfshirë rënien e çmimeve të mallrave, rënien e turizmit, varësinë e lartë të remitancave dhe ndërprerjet e konsiderueshme të zinxhirit të vlerës. Të gjitha ekonomitë do të përjetojnë deficite të konsiderueshme buxhetore dhe çështje të likuiditetit të shkaktuara nga aktiviteti i kufizuar ekonomik. Reduktimi i dërgesave do të shtojë tensionin ekonomik, ndërsa ekonomitë me varësi të lartë nga sektori i turizmit, si shumica e vendeve të BP-së, do të preken rëndë për shkak të kufizimeve të udhëtimit dhe efekteve të pandemisë në mbarë botën. Kjo do të thotë se në këtë situatë të vështirë, bashkëpunimi i vendeve midis tyre nëpërmjet krijimit të Zonës Ekonomike Rajonale, mund të përbëjë një zgjidhje për të kapërcyer krizën. Një zonë e tillë do të ndihmonte në krijimin e zinxhirëve rajonalë të vlerës, duke bërë të mundur dhe specializimin e secilit vend në prodhimin e ofrimin e atyre produkteve e shërbimeve që nevojiten, për ta bërë rajonin më të konkurrueshëm si një i tërë.

Vlerësimi i zbatimit të Planit Disavjeçar të Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale (REA MAP)

Kjo analizë[1] synon të paraqesë një vlerësim të situatës së jetësimit të masave REA MAP deri në vitin 2020, ndarë sipas shtyllave përkatëse të planit të veprimit: tregti, investime, lëvizshmëri dhe digjitale.

Synimi është që masat të analizohen sipas rolit që kanë në formimin/afrimin, drejt një tregu të përbashkët dhe problematikat e hasura për t'u jetësuar/zbatuar.

Masat që afrojnë Ballkanin Perëndimor drejt një tregu të përbashkët, të përfshira në Planin Disavjeçar të Veprimit, karakterizohen nga tre vështirësi kryesore:

1. mungesë vullneti politik,
2. mungesë mbështetje financiare,
3. vonesa për shkak të burokracive në koordinimin e zbatimit të tyre si dhe/ose për shkak të mosmarrëveshjeve bilaterale ende të pazgjidhura.

Masat e lidhura me shtyllën e tregtisë dhe investimeve janë tipike për tipin e tretë të vështirësive. Ato janë masa të cilat nuk kërkojnë mbështetje të madhe financiare si dhe ekziston një vullnet politik i shprehur për t'i kryer. Nga ana tjetër ka një ngarkesë të madhe administrative për jetësimin e tyre, pasi vendet duhet të ndryshojnë dhe përafrojnë procedura komplekse doganore, apo të pranimit të investitorit të huaj dhe trajtimit të tij si vendas. Masat e shtyllave digjitale dhe të lëvizshmërisë janë aty ku hasen kryesisht mangësi të vullnetit politik për t'i jetësuar, veçanërisht në rastet kur ka ndërthurje me mosmarrëveshje bilaterale të mbartura, apo ka mungesë të financimit për shkak të faturave të mëdha që shoqërojnë këto masa.

Shtylla e Tregtisë

Masat në shtyllën e tregtisë, janë masat që kanë hasur ngarkesën më të madhe tekniko-burokratike. Masat e kësaj shtylle janë të ndërlidhura me mirëfunksionimin e CEFTA (Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë në Evropën Qendrore) dhe kërkojnë angazhim administrativ të konsiderueshëm. Thelbi i shtyllës së tregtisë, është jetësimi i Protokolleve Shtesë 5, 6 dhe 7 të CEFTA. Këto protokolle shtesë të marrëveshjes në kuadër të CEFTA, janë themeli i një tregu të përbashkët pasi mundësojnë lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve. Thjeshtimi i procedurave doganore dhe zbatimi i programeve të përbashkëta të njohjes reciproke, është një masë thelbësore për jetësimin e AP5. Zbatimi i saj pritet

1. Analiza është bazuar në vlerësimin e arritjeve të deritanishme të raportuara në takimet rajonale nga vendet e BP-së apo në raportet e vlerësimit të hartuara nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Sekretariati i CEFTA-s, para Samiteve Rajonale, të organizuara në kuadër të procesit të Berlinit.

të shkurtojë konsiderueshëm kohën e pritjes në dogana të mjeteve që transportojnë mallra. Programi i parë mbi unifikimin e certifikatave dhe dokumentacionit për produktet bujqësore, fruta/perime, u miratua në takimin e dhjetorit 2019 të CEFTA. Problemi qëndron tek diferencat në përgatitje mes vendeve të BP-së. (P.sh. Kosova akoma nuk e ka ratifikuar AP5). Njohja e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (AEO) në administratën doganore, është një nga masat që ka marrë mjaft vëmendje nga vendet e po merren të gjitha hapat e nevojshëm që të arrihet. Por, nevojitet rritje e sensibilizimit të operatorëve si dhe trajnim i vazhdueshëm i tyre, për të arritur njohjen e një numri të konsiderueshëm të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (AEO) në rajon.

Krijimi i një platforme e-commerce, që do të ndihmonte në jetësimin e AP5 dhe AP6, pasi do lehtësonte aksesin në tregje, sidomos, të bizneseve të mesme dhe të vogla, është një nga masat që nuk ka pasur zhvillimin e dëshirueshëm. Deri më tani nuk ka një studim rajonal të BP-së, për impaktin që do ketë krijimi i një platforme të tillë. Gjatë 2019-2020, Banka Botërore kreu një studim mbi e-commerce në Shqipëri, si dhe mundësinë e zgjerimit/forcimit të saj, në kuadrin rajonal të BP-së. Problem mbetet mungesa e një harte (mapping) të pengesave ligjore dhe administrative për mirëfunksionimin e e-commerce.

Shtylla e Investimeve

Miratimi i Planit të Veprimit të Reformave të Investimeve (IRAP), nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 13.2.2019, "Për miratimin e Planit të Veprimit të Reformave të Investimeve (IRAP)", më 16 Korrik 2019, është një hap i rëndësishëm në këtë shtyllë. Kjo është ndër masat kryesore në formimin e një tregu të përbashkët. Sfidë mbetet jetësimi i IRAP, rritja e kapaciteteve brenda institucioneve shqiptare për zbatimin e Agjendës së Reformës së Investimeve (RIRA), të formalizuar nëpërmjet Planit të Punës së Reformës së Investimeve (IRAP); Agjenda e përbashkët e promovimit të rajonit si një destinacion unik për investitorët e huaj. Megjithëse vendet e rajonit kanë organizuar (individualisht) herë pas here fushata promovimi për investime potenciale, ekziston problemi se nuk ka një koordinim të mirëfilltë mes 6 vendeve, për të prezantuar Ballkanin Perëndimor si një destinacion unik investimesh.

Shtylla e lëvizshmërisë

Kjo shtyllë duket se ka mangësinë më të madhe të vullnetit politik të qeverive të rajonit, shprehur qartë kjo në ndërprerjen e negociatave për Marrëveshjen e Përbashkët Rajonale, për lëvizshmërinë e lirë të profesionistëve brenda rajonit (MRA) dhe Deklaratën e Njohjes së Kualifikimeve Akademike. Këto janë 2 masa kyç për mundësimin e lëvizjes së kapitalit njerëzor, për arsye ekonomike. Të dyja janë masa me impakt të lartë në formimin e një tregu të përbashkët, pasi do mundësonin një element thelbësor: lëvizshmërinë e kapitalit njerëzor dhe dijes. Ndërkohë që masa të cilat janë të realizueshme, por kanë pasur vonesa si pasojë e problemeve teknike, janë hartëzimi (mapping) i infrastrukturës kërkimore në rajon (zbatimi i kësaj mase është në proces dhe pritet të përfundojë gjatë 2020) dhe hartimi i Strategjisë Inteligjente S3 (Smart Specialization Strategy), e cila ka për qëllim prioritizimin e sektorëve të ekonomisë së vendit. Shqipëria, dhe Maqedonia e Veriut, janë në fazën fillestare të këtij procesi. Problemi kryesor është financimi i procesit dhe mungesa e ekspertizës për hartimin e një strategjie të tillë. Mbështetja tek palë të treta për të siguruar si financim dhe ekspertizë, ka sjellë disa vonesa. Ndërkohë që Serbia dhe Mali i Zi janë në fazën përfundimtare të hartimit, ndërsa Kosova dhe Bosnje-Hercegovina, akoma nuk e kanë filluar procesin.

Shtylla digjitale

Masat në shtyllën digjitale janë ato që po ecin më mirë, edhe pse me ritëm jo mjaft të lartë. Nënshkrimi i Marrëveshjes Rajonale të Roaming (RRA) gjatë Samitit Digjital në Beograd, në Prill 2019, solli ulje të konsiderueshme të kostove të roaming-ut, për të gjithë përdoruesit e celularëve të BP-së, duke filluar nga 1 korriku 2019. RRA-ja konsiderohet si një nga arritjet më të rëndësishme të REA MAP dhe të zbatimit të Agjendës Digjitale Rajonale. Qëllimi final i marrëveshjes, është aplikimi i regjimit Roam Like At Home (RLAH), që nga 1 korriku 2021 në rajon (tarifa të njëjta në të gjitha vendet e rajonit). Deri më tani po ecet me hapa mjaft të mira në drejtim të arritjes së këtij qëllimi.

Gjithsesi, vlen të përmendet se pavarësisht progresit dhe rezultateve të arritura dhe rolit të shtyllës

digjitale në axhendën e përgjithshme të reformës ekonomike, tregu digjital i BP-së, është akoma shumë i fragmentuar, me infrastrukturë digjitale të pazhvilluar, pabarazi të konsiderueshme midis zonave urbane dhe rurale, si dhe një nivel të pabarabartë harmonizimi me Acquis-in e BE-së.
Kjo shtyllë ka vështirësitë më të mëdha të natyrës teknike. Shtylla digjitale përbëhet nga masa të karakterit të përgjithshëm të përgatitjes së mjedisit të përshtatshëm infrastrukturor-fizik, si dhe masa të tjera që janë zgjidhje (solutions) dhe shërbime (services), të cilat mbështeten mbi infrastrukturën.

Plani Disavjeçar i Veprimit (2021-2024) – REA MAP 2.0

Vendet e BP-së kanë filluar të punojnë drejt përgatitjes së fazës tjetër të agjendës rajonale të integrimit ekonomik, e cila do të miratohet nga Udhëheqësit e BP-së, me rastin e Samitit të Procesit të Berlinit, në vjeshtë të vitit 2020. Ata kanë filluar të nxjerrin në pah masa që duhen përfshirë në Planin e ri të Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale dhe të identifikojnë sektorët më premtues, ku do të synohet forcimi i integrimit rajonal ekonomik në të mirë të të gjitha ekonomive të Ballkanit Perëndimor, duke rritur integrimin me tregun e vetëm të BE-së.
Procesi i konsultimit me qeveritë e BP6, tashmë ka filluar dhe si rezultat i të cilit, pritet të zhvillohet një plan veprimi i zgjeruar dhe i azhurnuar i REA 2021-2024, duke përfshirë masa pragmatike, me impakt të matshëm dhe të orientuar drejt objektivit të përbashkët rajonal të integrimit evropian. Procesi po koordinohet nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (Regional Cooperation Council-RCC), në bashkëpunim me Sekretariatin e CEFTA që udhëheq aktivitetet e lidhura me tregtinë. Vlen të përmendet këtu, se REA e re do të pasqyrojë dhe kontekstin e rimëkëmbjes post-COVID-19 në rajon dhe do të shërbejë si një bazë për t'iu përgjigjur dhe përmbajtur pasojave socio-ekonomike negative të pandemisë.
Ngjashëm me planin e rimëkëmbjes së BE-së, përgjigjet rajonale duhet të ndërtohen mbi një ekonomi elastike, të gjelbër dhe digjitale, me një fokus të fortë në ekonominë moderne dhe rrethore. Në dritën e zhvendosjes së mundshme të disa zinxhirëve globalë të furnizimit, si qeveritë evropiane ashtu edhe ato të rajonit tonë, do të duhet të punojnë së bashku për të mbrojtur zinxhirët thelbësorë të vlerës dhe për të zhvilluar të reja, në partneritet të ngushtë me sektorin privat.
Situata aktuale kërkon rregullime dhe transformime socio-ekonomike të rajonit, duke mbështetur dhe përmirësuar qasjen drejt: transformimit digjital dhe inovacionit, si shtyllë kurrizore e përpjekjeve rajonale të integrimit ekonomik, duke u bazuar në zhvillimin e mëtejshëm të masave të ndërmarra në kohë krize, si: ndërtimi dhe funksionimi i Korridoreve të Gjelbërta, në BP dhe BE; politikat dinamike industriale; mbështetje më e integruar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) përmes partneriteteve inovative dhe platformave digjitale; forcimi i kapitalit njerëzor për të përmirësuar cilësinë e arsimit, për të adresuar mospërputhjen e aftësive dhe atyre digjitale për shkak të përhapjes së shpejtë të teknologjive të reja.
Objektivat e integrimit ekonomik rajonal, duhet të përputhen plotësisht me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (GAWB), që pritet të bëhet së shpejti realitet.
Drafti i Planit të Veprimit të propozuar të REA 2.0, është rishikuar si në strukturë ashtu edhe në përmbajtje nga ai i mëparshmi. Shtyllat dhe nën shtyllat, janë rishikuar dhe ndarë në fusha e sektorë më të përqendruar.
Shtyllat e lidhura me tregtinë dhe investimet kanë në fokus kryesisht lidhjen e ekonomive, lëvizjen e lirë të mallrave, lëvizjen e lirë të shërbimeve, lëvizjen e lirë të kapitalit që përfshin në vetvete masa të tilla, si: zhvillimi i një sistemi modern të pagesave, zhvillimi i integruar i tregjeve të kapitalit në rajon, etj.
Zhvillimi i një hapësire rajonale të investimeve, është një objektiv tjetër i mbartur nga Plani i kaluar i Veprimit. Kjo hapësirë synon nxitjen e investimeve rajonale, përfarimin e politikave rajonale të investimeve ne vendet e BP-së, si ruajtjen e investimeve aktuale dhe thithjen e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), të reja në rajon.
Shtyllat që lidhen me lëvizjen e lirë të kapitalit njerëzor, përfshijnë masat që lidhen me lëvizjen e lirë të njerëzve, lëvizshmërinë e studentëve, studiuesve dhe profesorëve, lëvizshmërinë e individëve me karta identiteti dhe heqjen e lejeve të punës.
Shtyllat që lidhen me sektorin digjital, kanë si synim

kryesor krijimin e Zonës Digjitale Rajonale. Një qëllim tjetër, është dhe nxitja e investimeve në infrastrukturën digjitale për mbështetjen e e-learning, për të siguruar konektivitet me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë, për të mundësuar mësimin cilësor, rritjen e-skills-ave për bizneset, kryesisht të vogla (micro), që operojnë në zona më të thella rurale, ku mungon aksesi në internet, për të mundësuar operimin dhe gjenerimin e të ardhurave të bizneseve të vogla (ku përfshihen kryesisht ato artizanale, por dhe shtëpitë pritëse të cilat prodhojnë dhe produktet e tyre të zonës).

Shtyllat që lidhen me inovacionin dhe industrinë, janë shtylla të reja që i janë shtuar Planit të Veprimit. Masat që përfshihen këtu kanë si objektiv krijimin e një hapësire rajonale industriale dhe inovative. Inovacioni shihet si një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e vendeve të rajonit, sidomos kur flitet për inovacion në fushën e industrisë dhe përfshirjen e vendeve te BP-së, në zinxhirët evropianë të vlerës. Disa sektorë të ekonomisë që shihen si prioritarë në vitet që vijnë, janë industria e turizmit, industria e automobilave dhe ekonomia e gjelbër dhe rrethore (circular economy). Masat synojnë rritjen e iniciativave dhe investimeve në këto industri, në të ardhmen e afërt.

Rekomandime dhe konkluzione

Plan i ri i Veprimit i Zonës Ekonomike Rajonale (REA 2.0), është ende duke u hartuar dhe përmirësuar përmes komenteve të ndryshme të dërguara nga 6 ekonomitë, të cilat po punojnë drejt zhvillimit të një pamje më të mirë dhe të përshkruajnë hapat e ardhshëm të nevojshëm për të konsoliduar dhe forcuar planin e veprimit.

Ky dokument duhet të përkthehet në një udhërrëfyes të mirëfilltë real, me vizion të qartë dhe masa dhe veprime që mund të zbatohen vërtet dhe të kenë mbështetjen nga qeveritë e rajonit. Masat e këtij Plani të ri, duhet të formulohen në një mënyrë të tillë që të jenë sa më të arritshme dhe të kenë impakt konkret e të matshëm në publikun e gjerë.

Ekziston nevoja për të pasur një qasje selektive për ato aktivitete që mund të nxisin me të vërtetë integrimin e BP-së, në tregje të reja. Ekzistojnë shumë mundësi që do të shfaqen pas krizës aktuale të COVID 19 dhe vetë KE-ja po diskuton për zhvillimin e politikave të reja strategjike, duke kërkuar mënyrën për ta sjellë BP-në më afër BE-së. 6 vendet e rajonit janë në gjendje relativisht të mirë për të tërhequr investime të huaja dhe për të siguruar një Zonë të vërtetë Ekonomike në rajon duke përfituar dhe nga pozicioni i privilegjuar i BP-së, afër BE-së.

Është e rëndësishme që vendet të mos bien pre e proceseve burokratike dhe teknokratike, por të ndërtojnë një udhërrëfyes të qartë, me masa shumë konkrete e me interes ekonomik për vendet, i cili është në të njëjtën kohë tërheqës për të fituar mbështetjen e udhëheqjes politike të rajonit.

Këtë herë vendet duhet të mësojnë nga e kaluara e të bëjnë çmos, të mos mbipopullojnë agjendën me çështje të cilat mund të adresohen në forume, ose përmes iniciativave të tjera. Fokusi duhet të jenë angazhimet e qeverive të rajonit, për të zbatuar masa me impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendeve të tyre dhe në publikun e gjerë. Masat e propozuara, duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme për qeveritë dhe qytetarët. Prandaj, është e rëndësishme që 6 vendet të arrijnë të artikulojnë e miratojnë një dokument, që mund të kuptohet dhe mund të shpjegohet lehtë. Nevojitet që niveli i komunikimit lidhur më Zonën Ekonomike Rajonale, të rritet në mënyrë të ndjeshme me publikun, bizneset e të rinjtë, pasi ata janë përfituesit e këtyre politikave të ndërmarra nga vendet.

Sektori privat duhet të luaj një rol më të madh në hartimin e zbatimin e këtij Plani të ri Veprimi, pasi do të rezultojë jashtëzakonisht e dobishme, për të gjitha palët e përfshira. Për këtë duhet synuar një përfshirje më e madhe nga CIF (Chamber Investment Forum), në zbatimin e Planit të Veprimit. Do të jetë jashtëzakonisht e dobishme për të gjithë, që të kenë zërin e sektorit privat të operatorëve ekonomikë, të përfaqësuar në këtë ushtrim. Kjo mund të arrihet nëpërmjet zhvillimit të një mekanizmi/platforme/komiteti, të përbërë nga kompani të sektorit privat në rajon, i cili do të japë mendimin e tij për çështje të ndryshme të REA dhe do të sjellë realitetin nga terreni. Kjo do të lejojë të krijohet një pasqyrë më e qartë se çfarë nevojitet me të vërtetë nga bizneset, si po zbatohen masat REA dhe çfarë duhet të përmirësohet, në kohë reale.

Siç është përmendur gjithashtu nga KE-ja, Agjenda e Gjelbër dhe Agjenda Digjitale, do të jenë dy nga

faktorët e rimëkëmbjes ekonomike pas Covid-19 për BE-në dhe për rajonin, dhe natyrisht për nxitjen e rritjes ekonomike afatgjatë. Si rrjedhim ekonomitë e BP-së, nevojitet të hartojnë një vizion të përbashkët lidhur me Agjendën Digjitale, në mënyrë që KE-ja të ndihmojë ekonomitë e BP-së, për ta materializuar atë, kryesisht përmes instrumentit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (Western Balkans Investment Framework - WBIF), i cili ka si qëllim financimin e projekteve të përbashkëta rajonale. Këto dy agjenda do ta bëjnë REA-n më tërheqëse për investime, si investimet e gjelbra ashtu edhe ato në fushën digjitale.

Në fushën digjitale nevojitet "lobim" tek EC-janga vendet e rajonit, për çeljen e një fondi të dedikuar për ngritjen e infrastrukturës digjitale. Ky fond mund të mbështesë projekte që fokusohen në zhvillimin e rrjetit broadband kombëtar (sipas nevojave që kanë rezultuar nga studimet e fizibilitetit apo studime të ngjashme të kryera në vendet e rajonit) si dhe ndërtimin e linjave ndërkombëtare (nën-detare e tokësore), me vendet e tjera të rajonit dhe me vendet e BE-së. Kjo mund të arrihet duke gjetur një formulë bashkëpunimi me sektorin privat, ku EC-ja mund të mbështesë me një pjesë të fondeve, investimet e tyre për shtrirjen e internetit, subvencionim për blerjen e antenave apo pajisjeve satelitore, duke bërë të mundur "matching" B2B të operatorëve që ofrojnë internet (kryesisht me lidhje satelitore), me operatorët në Evropë (për të bërë marrëveshje që do ndikonin tek ulja e çmimit të ofrimit të shërbimit të internetit nga operatorët shqiptarë). Ndërsa qeveritë mund të kenë një rol koordinues lidhur me prioritizimin e zonave "të zeza", si dhe mbështetjen e sektorit privat që operon në këtë fushë për reduktimin e burokracive lidhur me licencat përkatëse që nevojiten për çarjen e rrugëve (në rastin e fibrës), apo lejet e ndryshme që nevojiten për vendosjen e antenave të reja në zona të ndryshme.

Siç përmendet dhe në komunikimin e Komisionit Evropian mbi mbështetjen e BE-së, për BP-në, për të dalë nga kriza e Covid-19, një tjetër fushë ku nevojitet rritja e investimeve, është ajo që lidhet me aftësitë digjitale, kryesisht të SME-ve. Më shumë detaje rreth këtij komunikimi mund të gjenden në linkun

Në periudhën afatshkurtër, fokusi duhet të vihet tek tregtia elektronike (e-commerce). Nevojitet mbështetje për rritjen e aftësive digjitale të bizneseve për ta kaluar biznesin e tyre online, si dhe për konsumatorët për të mundur të bëjnë blerje online. Kjo mund të arrihet nëpërmjet videove trajnuese për biznesin apo konsumatorin, organizimit të Webinar-ëve, apo të ofrimit të ekspertëve të dedikuar për bizneset. Këto do të ndikonin në zhvendosjen e bizneseve tradicionale, drejt digjitalizimit të aktiviteteve e shërbimeve që ofrojnë dhe edukimit të konsumatorit për t'i përfituar këto shërbime lehtësisht.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mjaft potencial për të zhvilluar iniciativa e reforma rajonale me impakt mjaft të gjerë. E rëndësishme është që fryma e ngritur tashmë e bashkëpunimit të vazhdojë të ekzistojë e të forcohet më tej, duke patur gjithmonë në mendje se përfitimet në nivel rajonal përkthehen në përfitime edhe më të mëdha në nivel kombëtar.